



**KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

**V E N D I M**

Nr. 5, Datë 17.05.2019

**PËR  
MIRATIMIN E RISHIKIMIT TË PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR  
BASHKIA KORÇË**

Në mbështetje të neneve 7, 20, 25 dhe 26 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të neneve 11 dhe 12 të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, të ndryshuar si dhe të Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 7, datë 08.02.2017 të KKT-së “Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Korçë”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Korçë, si dhe referuar Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 27, datë 28.02.2018 Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Korçë, pjesë e të cilit është dokumenti i mëposhtëm:
  - *Dokumenti i Rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Korçë*
2. Ngarkohen Bashkia Korçë dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për botimin e Vendimit dhe dokumentit shoqërues të tij, në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit, si dhe për përditësimin e informacionit GIS dhe platformës e-Harta, sipas ndryshimeve të miratuara.
3. Ngarkohen Bashkia Korçë, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, si dhe autoritetet përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

  
BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

